



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE E UJËSJELLËS KANALIZIME VLORE SH.A

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje Klori”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

24311900-6 Klor

VLERA E FONDIT LIMIT:

15,296,000 (*pesëmbëdhjetë milion e dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë*) **lekë pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Vlore sha** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe shtojcës 8 të DST-së (Shënim: *përcaktoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit*).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vertetim për xhiron vjetore për tre vitet e fundit, ku vlera mesatare e xhiros në të paktën njërin prej tre viteve të fundit të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit të këtij prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë që ky kriter kualifikues të shërbejë Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.3 Kapaciteti teknik:

1-Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim të importit të lëndëve dezinfektante për trajtim të Ujit të pijshëm lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë të Shqipërisë për lëndet (në rast se

nuk janë prodhim vendas),

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë autorizim për hedhjen në treg të lendeve, për furnizimin e mallit objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet përkatëse (Ministrise së Shëndetësisë.) Bazuar në Urdhrin e Ministrise së Shëndetësisë Nr.202 datë 23.05.2014 *”Per autorizimin e importit për produktet biocide dhe miratimin e listës së produkteve biocide për DDD në shëndetin publik dhe produkteve për trajtimin e ujit të pijshëm të lejuara për tregëtim dhe përdorim në Republikën e Shqipërisë”.*

Ligji Nr.95/2015 *”Per shërbimet dhe produktet biocide në Shëndetin Publik”*,neni 2 *”Objekti”*,neni 8 *”Autorizim për berje të disponueshme për treg të produkteve biocide”*, neni 9- *”vendosja në treg e produkteve biocide”*

Vendosja e këtij kriteri ka për qëllim sigurinë se operatori pjesëmarrës garanton se lendet e kerkuara për desinfektimin e ujit të pijshëm janë në përputhje me parametrat cilësorë të standarteve për këto lende si dhe subjekti tregëtuës përmbush kapacitetet e nevojshme për tregëtimin e këtyre lendeve pasi tek Autorizimi I dhënë nga MSHSH përcaktohet edhe sasia e lendes që subjekti lejohet të tregëtoj.

2-Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikate për Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2015 ose ekuivalent të saj .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 44, pika 1 dhe 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*,

*“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, **mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata** të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”*

Ky kriter është vendosur me qëllim që të garantohet siguria se lendet e kerkuara për desinfektimin e ujit të pijshëm janë sipas parametrevë të kerkuara në standartet për këto lende

3-Operatori ekonomik duhet të japë dëshmi me dokumentacion ku tregojnë se ata plotësojnë kërkesat e Autoritetit Kontraktor mbi specifikimet teknike të këtyre lendeve që prokurohen si më poshtë:

3/1- Certifikatë që vërteton konformitetin e produkteve në prokurim me normat Europiane (të përkthyer e të noterizuar në shqip kur është prodhim i huaj)

3/2-Raporte analizë të lëndës për rezultatet e testimeve, të lëshuara nga Institucione të autorizuar Shqipëtare, kompetentë për ekzaminimin ,dhënie të Lejes së përdorimit të lëndës si dezinfektante për Ujin e pijshëm (ISHP Tiranë)

a-Raport analize Fiziko-Kimike

b-Raport analize Toksikologjike (përmbajtje të metaleve të rënda)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 36,pika 3/b,neni 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nennt 40, pika 6, germa a dhe c,) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se për lenden e kerkuar ne kete prokurim,siguron vetite fizike kimike te lendes jane percaktuar dhe vleresuar si te pranueshme per qellime qe lidhen me perdorimin, ruajtjen dhe transportin e duhur te produktit. Bazuar ne Ligjin Nr.95/2015 ”Per sherbimet dhe produktet biocide ne Shendetin Publik”,Neni 7, pika 1, germa dh;

4-Operatori ekonomik duhet te paraqes nje deklarate me shkrim ,te noterizuar ku :

4/1-Operatori deklaron me pergjegjesi te plote se siguron ne sasi e cilesi gjithe mallin e prokuruar nga Autoriteti Kontraktor.

4/2-Operatori deklaron me pergjegjesi te plote qe do te kryhej furnizimin me lendet me mjete transporti te tij.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5, germa ç; të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deshmoje se garantojne transportin me mjete te sigurta dhe te pershtatshme per keto lende kimike, te cilat nuk ekspozojne ngarkesen ndajshiu, jane lehtesisht te pastrueshme, te pajisura me mjetet te mbrojtjes personale, te pajisura me mjetet e emergjences dhe ndihmes se pare mjekesore, te pajisura me mjete kundra zjarrit. Bazuar ne nenin 10, pika 1,pika 2, dhe pika 3 e Ligjit Nr.95/2015 ”Per sherbimet dhe produktet biocide neShendetin Publik”,

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim

Njesia e Prokurimit